

VENDIM
Nr. 433, datë 15.7.2021

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 239, DATË 20.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KËRKESAT TEKNIKE DHE FUNKSIONALE TË ZGJIDHJES
***SOFTWARE*-IKE, PËR PROCEDURËN E FATURIMIT DHE TË FISKALIZIMIT, SI**
DHE PROCEDURËN E KRITERET PËR REGJISTRIMIN E PRODHUESVE E TË
MIRËMBAJTËSVE TË ZGJIDHJEVE *SOFTWARE*-IKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 16, të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 239, datë 20.3.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 12, të kreut III, “Regjistrimi i prodhuesve dhe mirëmbajtësve të *software*-it”, shtohet pika 12.1, me këtë përmbajtje:

“12.1 Subjektet aplikuese kanë detyrimin të dorëzojnë pranë AKSHI-it *software*-in me të njëjtat të dhëna si në aplikimin *on-line* jo më vonë se dita e nesërme e punës nga aplikimi në *e-Albania*. Në rast mosdorëzimi, subjekti do të duhet të riaplikojë në *e-Albania*.”.

2. Në kreun IV “Certifikimi i Programit (*Software*)” bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 14 shtohet pika 14.1, me këtë përmbajtje:

“14.1 Prodhuesi ose mirëmbajtësi i certifikuar i zgjidhjes *software*-ike, me kërkesë të AKSHI-t dhe të DPT-së, dorëzon versionin e përmirësuar të *software*-it brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit, në rastet kur përmirësimi i kërkuar nuk sjell ndryshime thelbësore në *software*. Nëse përmirësimi i kërkuar sjell ndryshime thelbësore në *software*, dorëzimi i versionit të përmirësuar të *software*-it bëhet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit.”.

b) Pas pikës 16 shtohet pika 16.1, me këtë përmbajtje:

“16.1 Pas marrjes së vendimit nga ana e komisionit për miratimin e aplikimit, të dhënat e certifikatës do të plotësohen me ato të dhëna që aplikuesi ka deklaruar elektronikisht në aplikim për certifikim në portalin *e-Albania*”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 113, datë 16.07.2021